



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA E LARTË  
KANCELARI

Nr. 4604/1 prot

Tiranë 22.09.2023

**Lënda :** Njoftim mbi rezultatet e verifikimit paraprak të kandidatëve për procedurën e konkurrimit  
“Ngritje në detyrë dhe pranim në shërbimin civil gjyqësor”

Në zbatim të nenit 57, të Ligjit 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, të neneve 9 dhe 17, të vendimit nr. 622, datë 10.12.2020, “Për lëvizjen paralele, ngritjen në detyrë dhe pranimin në shërbimin civil gjyqësor”, udhëzimit nr. 85, datë 11.03.2021 “Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil gjyqësor nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele dhe pranim në shërbimin civil gjyqësor”, në përfundim të afatit kohor datë **21.09.2023** për dorëzimin e dokumentave personale për pozicionet e lira dhe nga verifikimi paraprak i dokumentacionit të kandidatit, për përmbushjen e kërkesave të përgjithshme dhe të veçanta të shpallura për konkurrim, sipas procedurës “Ngritje në detyrë dhe pranim në shërbimin civil gjyqësor” Kancelari i Gjykatës së Lartë për pozicionet e shpallura në të tre njoftimet e datës 01.09.2023 njofton se :

**I. Procedura “Ngritje në detyrë”**

- **1(një)** vend vakant “*Drejtor/e- Drejtorja e Burimeve Njerëzore, Financiare dhe Shërbimeve*” ( *kategoria e mesme drejtuese II-2*) kandidat i kualifikuar është :

**Znj.Anila Kulo**

*Nëse rezulton që edhe sipas kësaj procedure nuk do të ketë kandidatë të kualifikuar atëherë do vijohet plotësimi i kësaj vakance sipas procedurës “Pranim në shërbimin civil gjyqësor”.*

- 1(një) vend vakant **“Përgjegjës/e sektori, Sektori i sigurisë dhe ruajtjes së rendit-Drejtoria e Teknologjisë së Informacionit dhe Sigurisë“**,(kategoria ekzekutive, III-1) , kandidat i kualifikuar është :

**Z. Adrian Dervishi**

*Nëse rezulton që edhe sipas kësaj procedure nuk do të ketë kandidatë të kualifikuar atëherë do vijohet plotësimi i kësaj vakance sipas procedurës **“Pranim në shërbimin civil gjyqësor“**.*

**II. Procedura “Pranim në shërbimin civil gjyqësor”**

1. **2 (dy)** vende vakante për pozicionin **“Specialist/e -Qendra e Dokumentacionit “** (kategoria ekzekutive, IV-1) kandidaturat e kualifikuara janë:

**1.Znj.Matilda Boja**

**2.Znj.Ina Nikolla**

**3.Z.Nertil Çausi**

**4.Edis Mustafa**

Për kandidatët që konkurrojnë sipas procedurës **“Pranim në shërbimin civil gjyqësor”** provimi më shkrim do të zhvillohet më datë **25.05.2023, ora 13.00.**

Pas daljes së rezultateve të provimit me shkrim intervista e strukturuar me gojë për të gjithë kandidatët e kualifikuar për vakancat e shpallura do të zhvillohet më datë **27.09.2023. ora 13.00.**

- III.** Për kandidatët që kanë shprehur interes për vendin vakant **“Specialist/e e marrëdhënieve me publikun – Drejtoria e Marrëdhënieve me Publikun dhe me Jashtë”**, do vijohet me procedurën e “Pranimit në shërbimin civil gjyqësor”, nëse rezulton akoma vendi vakant pas rezultateve përfundimtare të procedurës “Lëvizje paralele”.

**KANCELARI NË DETYRË**